



---

## Raport mbi ecurine e veprimtarise

Ky dokumentacion konsiston ne:

- Hartimin, perpunimin dhe negocimin e kontrates me Ministrine e Bujqesise, e cila u firmos me date 07.10.2014.

Per te mbuluar nje siperfaqeje te madhe me sera, per te bere te mundur implementin e biznes planit te shoqerise, si dhe per te hartuar nje strategji te qarte te zhvillimit te shoqerise u ndoqen keto hapa:

U kerkua thirrja e nje eksperti te bujqesise nga PUM Netherlands, i cili kreu nje mision ne Shqiperi nga data 27.07 deri me date 02.08.2014. Eksperti Z. Loek KOOP dergoi nje raport ne lidhje me viziten e tij ne Shqiperi. Ne perfundim te raportit synimi i kompanise BAI, ishte percaktuar shprehimisht si: Ndertimi i nje siperfaqe deri ne 50 ha me sera high tech per prodhimin e produkteve bioorganike sipas te gjitha rregullave te BE, duke ruajtur ne maksimum jedisin.

Per ndertimin e kesaj siparfaqe te madhe u shqyrtuan te gjithë resurset e zones dhe ato qe ofron vendi yne. Nje nder keto resurse eshte ujitja, dhe per ujitjen mundesia e vetme eshte ndertimi i puseve. Natyrisht duke qene se ne kete zone ka puse te ngritura, nga te cilat furnizohen Shijaku, Fushe – Kruja dhe Fabrika e Cimentos, u firmos nje kontrate me firmen INA-96 Shpk, e cila realizoi edhe projektin hidrogeologjik per vendet ku u ndertuan puset, ne menyre qe BAI te marre sasine e nevojshme ditore te ujit duke mos ndikuar furnizimin me uje te popullsesise.

Per kete projekt eshte marre miratimi zyrtar nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, e me pas eshte marre leja per shpimin e puseve.

Gjate periudhes Gusht-Shtator 2014 u moren me qira ambjentet e zyrave prane siperfaqes se tokes me qira dhe vazhdoi puna per rikonstrukcionin e tyre.

Puna e Kompanise Besa Agro Invest ne muajt Tetor-Nentor u perqendrua ne implementimin e planit te biznesit qe u dorezua ne Ministrine e Bujqesise.



Me daten 07.10.2014, u arrit te firmoset kontrata me Ministrine e Bujqesise per marrjen me qira te nje sip. Toke prej rreth 82.6 ha.

Me date 19 Nentor 2015, u be inagurimi i funksionimit te shoqerise, aktivitet ne te cilin ishin te pranishem Kryetari i Kuvendit te Shqiperise z. Ilir Meta, Ministri i Bujqesise z. Edmond Panariti, Ministri i Ceshtjeve Sociale z. Erion Veliaj si dhe perfaqesues te ndryshem te trupit Diplomatik dhe Deputete te Kuvendit.

Shoqeria aktualisht ushtron aktivitetin e saj, e bazuar tek lejet, licensat, aprovimet dhe autorizimet e tjera te ligjshme te leshuara nga institucionet qeveritare kompetente te fushes.

**Objekti i saj eshte:** kultivimi i kulturave te ndryshme bujqesore dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice. Kultivimi i ullirit, vreshtave, pemeve frutore, me qellim tregtimin e produkteve dhe nenprodukteve te tyre me shumice dhe pakice. Prodhimi i farerave dhe fidaneve per tregtimin e tyre. Ngritja e industrise perpunuese te prodhimeve bujqesore dhe blegtorale. Ngritja dhe zhvillimi i agroturizmit. Eksperimentimi me teknologjite e reja per kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore. Import-eksporti dhe tregtimi me shumice dhe pakice te te gjitha prodhimeve bujqesore dhe blegtorale te perpunuara, te fresketa dhe te gjalla, blerja e farerave, fidaneve, medikamenteve te ndryshme per mbrojtjen nga semundjet dhe demtuesit. Import-eksporti dhe tregtimi me shumice dhe pakice te makinerive per prodhim bujqesor dhe blegtoral, traktoreve, mjeteve te transportit si dhe linjat dhe makinerite e prodhimit te produkteve agro-ushqimore etj. Nxitja dhe organizmi i te gjitha aktiviteteve qe kane te bejne me prodhimin dhe tregtimin e prodhimeve te fermereve. Konsulenca ne fushen e ekonomise, bujqesise, blegtorise dhe ushqimit duke perfshire planet e menaxhimit te cilesise, mjedisit, turizmit dhe agro turizmit. Shoqeria ushtron aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licensat, aprovimet apo autorizimet e tjera te ligjshme te leshuara nga institucionet qeveritare kompetente te fushes.

Shoqeria ka raportuar dhe raporton periodikisht MBZHR mbi Progresin e Investmeve te kryera nder vite nga data e lidhje se kontrates se qirase me Ministrine.



Ne kete raport jane perfshire investimet e perfunduara nga momenti i lidhjes se kontrates se qerese deri me 31.12.2017. Ne tabelen ne fund te raportit jane dhene me shifra investimet e kryera deri me 31.12.2017 ne menyre kumulative qe nga fillimi i aktivitetit te shoqerise.

## 1. Investime te kryera ne infrastrukturen rrugore

Vendodhja e projektit eshte jo shume larg qytetit te Tiranes, 2-3 km nga qyteti i Fushe Krujes, prane fshatit Arrameras, ne anen e djathte te lumit Gjola, me rruge shume te pershtatshme per linjat e furnizimit me energji elektrike. Infrastruktura e brendshme e zones ka qene shume e veshtire.

Eshte investuar ne rikonstrukcionin e rruges ekzistuese te zones, e cila lidh kete rruge, me rrugen nacionale (kryesore). Gjithashtu, eshte investuar ne ndertimin e nje rruge me zhavor midis dy pjeseve te siperfaqes ne administrim, rruge e cila sherben edhe per nje pjese te komunitetit qe gjendet ne kete zone. Gjatesia e saj eshte 645 meter, me rreth 1161 m<sup>3</sup> gure dhe çakell.

Eshte ndertuar nje rruge e re me zhavorr qe lidh zonen e serave me zyrat qendrore, gjatesia e se ciles eshte 215 metra lineare, me siperfaqe 1700 m<sup>2</sup>.

Infrastruktura rrugore tek serat: E cituar dhe ne rastin e serave, per nevojat e funksionimit normal te aktivitetit te serave eshte projektuar, kontraktuar dhe finalizuar rreth 1 km rruge e brendshme, si dhe lidhja nga blloku i serave me zyrat qendrore tek BAI, **ne nje vlere rreth 8 milion leke**. Nderkohe, brenda nje afati 2 javor eshte rehabilituar dhe nje tjeter rruge e domosdoshme ne qender te parcelave, e konsideruar si «rruga e mesit», e cila sherben njekoheesisht dhe per komunitetin.

## 2. Kullimi i parcelave

Sikurse eshte informuar ne raportet e viteve te meparshme, ne fillimin e aktivitetit te shoqerise eshte gjetur nje gjendje shume e rende e kullimit te parcelave. Per kete, u hapen kanale dytesore kulluese, me ne fokus, kanalet ne parcelat ku mbillen dru-frutore. Per lidhjen e siperfaqes nen administrim me kolektorin e madh ne anen tjeter te rruges kryesore, rruge e



cila eshte e bllokuar nga ndertimet e qytetareve, ne bashkepunim me Bordin e Kullimit te Qarkut Durres, rame dakord si meposhte:

Kolektorin kryesor kullues e pastron Bordi i Kullimit te Qarkut Durres, dhe ne paguajme shpenzimet e karburantit, duke ulur ndjeshem koston e tyre te pastrimit.

Gjithashtu, per hapjen e te gjithe kanaleve te dyta kulluese, kryesisht per parcelat e mbjella me dru-frutore, eshte investuar per t'i kthyer ne toka te punueshme.

Rolin kryesor per situaten e paraqitur me foto si meposhte, e ka luajtur fakti qe fermeret e zones kane kultivuar vetem jonxhe, foragjere dhe miser si dhe fakti tjeter qe 30% e kesaj siperfaqeje eshte perdorur si toke kullote per bagetite e imta dhe te trasha.

Ne situaten ne te cilen nuk kishim asnje kanal te dyte apo te trete kullues funksional, e per pasoje pothuajse 60 % e siperfaqes se tokes ne periudhen e dimrit transformohej ne kenete, cka eshte pare nga ana jone qe me inspektimet e para te kryera ne parcelat e marra me qira prej Kompanise sone dhe me renien e shirave te pare, hapem kanale per te shfrytezuar mundesine e rishfrytezimit te drenazhimit qe eshte kryer ne te gjithe siperfaqen e marre me qera nga ana jone.

Gjate muajit Dhjetor 2014 u perfundua puna per pastrimin e kanaleve kryesore dhe dytesore si dhe u hapen disa kanale te tjera tresetore ne parcelat qe ishin mbjelle me grure.

*Foto pas nderhyrjes*

Ne kullimin e tokes, hasem veshtiresi per lidhjen e siperfaqes nen administrim me kolektorin e madh qe gjendet ne anen tjeter te ruges kryesore, pasi lidhjet gjendeshin te bllokuara nga ndertimet e qytetareve.

Per kete eshte investuar gjate muajve Nentor - Dhjetor 2015, ne ndertimin e nje kolektori te ri me dalje ne kolektorin kryesor. Ky investim ka vazhduar edhe pergjate vitit 2016.



*Permiresimi i kanaleve kullues buze serrave; nje nga problematikat e evidentuara ne kohe eshte se kanalet kullues te betonit, te ndertuara me synimin e largimit te ujerave siperfaqesore, nuk kane qene plotesisht efektive, si pasoje e mungeses se kuotave te duhura midis niveleve te tyre dhe nivelit te siperfaqes ne serra.*

Pasoja eshte shfaqur ne filtrimin e ujit ne pjesen e siperme te serrave, c'ka ka sjelle kushte jo te favorshme te perdorimit te ketyre pjeseve. Ne planin teknik, vleresuam te domosdoshme nderhyrjen per prishjen e pjeses se betonit prane serave, dhe krijuam nje kanal natyral kullues, ne kuotat e duhura per largimin e ujerave te tepert.

Per ndreqjen e kesaj situate, u moren masa nga supervizori dhe projektuesi i kompanise.

### **3. Puset, depozitat dhe Sistemi vadites**

Me rezultatet e studimit hidrogjeologjik, u hapen 4 puse, perkatesisht 2 ne pjesen jugore te tokave dhe 2 te tjere ne mesin e parcelave, te cilat ju sherbejne reciprokisht tokave te destinuar per mbjellje me dru-frutoreve dhe me perimore. Keto puse jane te pajisura me 4 pompa zhytесе.

Dy prej tyre jane vendosur prane bllokut te pemeve frutore dhe punojne ne kushte normale (me nje prurje 15 l/s), dhe 2 te tjeret punojne per siperfaqet e perimeve dhe serave, por kane mangesi ne prurjen sasiore te ujit (rreth 50% te sasise, apo 7-8 l/s). Per te siguruar ujin e domosdoshem ne rast defekti te puseve/pompave, investuam per ngritjen e 2 depozitave te ujit, me nje kapacitet 250 m<sup>3</sup> secila, dhe cdonjera e destinuar per pemet frutore, dhe perimoren dhe serat.

Nderkohe, per te bere te mundur qarkullimin e ujit ne brendesi te parcelave, u investua ne hapjen e kanaleve dhe shtrirjen e rreth 2,8 km tubacione plastike per vaditje. Ky investim i fundit u be nen presionin e thatesires se veres, si e vetmja mundesi vaditjeje per kulturat perimore. Ne kete sistem vadites, bejne pjese dhe 4 shihedhes te levizshem si dhe rreth 5 km tub plastik (dripa) per vaditjen me pika ne rreth 4 ha perime.

Sistemi vadites eshte i bazuar ne hapjen dhe funksionimin e 4 puseve, te pajisura respektivisht me 4 pompa zhytесе. Dy prej tyre jane destinuar prane bllokut te pemeve frutore dhe punojne ne kushte normale (me nje prurje 15 l/s), dhe 2 te tjeret te destinuar per



siperfaqet e perimeve ne fushe dhe sera, shfaqen mangesi ne prurje te sasise se ujit te parashikuar (rreth 50% te sasise, apo 7-8 l/s).

Per te siguruar ujin e domosdoshem ne rast defektesh te puseve/pompave, u investua per ngritjen e 2 depozitave te ujit, me kapacitet 250 m<sup>3</sup> secila, cdo njera e destinuar per pemet frutore dhe perimoret dhe serat.

Nderkohe, mundesuan qarkullimin e ujit ne brendesi te parcelave, duke investuar ne hapjen e kanaleve dhe shtrirjen e rreth 2,8 km tubacione plastike per vaditje. Ky investim eshte kryer nen presionin e thatesires se veres se vitit 2015, si e vetmja mundesi vaditje per kulturat perimore.

Ne kete sistem vadites bejne pjese dhe 4 shihedhes te levizshem si dhe rreth 5 km tub plastik (dripa) per vaditjen me pika te perdorur ne rreth 4 ha perime (spec dhe domate).

#### **4. Ndertesa**

Para inagurimit te kompanise eshte bere rikonstruksioni i plote i nderteses, duke e sjelle ate brenda te gjitha standardeve te kerkuara per nje ambjent pune. Eshte bere ndarja e zyrave me mure gipsi ne menyre qe te arrihet numri i deshiruar i ambjenteve te punes. Mjediset e punes jane komode dhe te pershtatshme per kryerjen normale te proceseve te punes nga ana e administrates.

##### Investimet ne ndertesa dhe paisje te zyrave

Persa i perket zyrave te administrates se shoqerise, jane kompletuar me te gjitha kushtet e nevojshme, si dhe jane vendosur mobiljet e nevojshme per krijimin e nje ambjenti bashkekohor dhe te pershtatshem per mbarevajtjen e punes. Te gjitha zyrat jane pajisur me tavolinen e punes, karriget dhe raftet e dosjeve. Gjithsej numerrojme 6 zyra dhe nje ambjent sherbimi vetem per administraten dhe punonjesit e shoqerise.

Gjithashtu gjate 2016, pervec investimit per krijimin e nje ambjenti te pershtatshem per magazinën e shoqerise, ku behet magazinimi dhe standardizimi i prodhimit qe vjen nga fusha, eshte investuar edhe ne ndertimin e nje qendre per seleksionimin e prodhimeve prane serave si dhe per ngritjen e dy qendrave te brigadave te prodhimit me aksesoret e tyre (tualet), duke krijuar kushtet e nevojshme te punes per punetoret e prodhimit.



### Pajisje zyre

Nderkohe, persa i perket zyrove, jane kompletuar me te gjitha kushtet bashkohore, duke vendosur mobiljet e nevojshme per krijimin e nje ambjenti modern dhe te pershtatshem per mbarevajtjen e punes. Te gjitha zyrat jane pajisur me tavolinen e punes, karriget dhe raftet e dosjeve.

Me pas eshte magazina, ku behet magazinimi i gjithe prodhimit qe vjen nga fusha, i cili, ne vijim standardizohet dhe behet gati per shitje.

### Pajisje informative

Per te arritur plotesimin e zyrove me te gjitha kushtet e nje ambjenti bashkekohor pune, nje pjese te shpenzimeve tona, ia kemi dedikuar edhe anes informative. Nuk mund leme pa permendur kompjuterizimin e cdo zyre, lidhjen me internet dhe centralin e brendshem te telefonise, kushte keto qe lehtesojne punen e perditshme.

### Logjistika

Tashme BAI eshte i pajisur me mjetet e domosdoshme per punimet bujqesore, transportin e prodhimit nga fusha ne magazine (prane zyrove) apo ne magazine te shitjes me shumice, si dhe mjetet ne varesi te nevojave te administrates. Keto mjete konsistojne ne :

- Toyota – drejtori
- Citroen – levizje te administrates
- furgon per levizjen e stafit
- furgon per levizjen e mallit
- dum dum – per levizjen ne parcele
- traktor te vogel – per pune bujqesore
- traktor te madh – per pune bujqesore
- Trktor Antonio carraro – per pune bujqesore
- Motorr – per levizjen ne parcele

*Perdorimi dhe karakteristikat e mjeteve si me poshte:*



Mjetet e mekanikes bujqesore;

- 1 traktor i fuqishem 100 kf, dhe
- 1 traktor 35 kf, per nevojat e punimeve bujqesore ne parcela dhe sera.
- Traktor Antonio TGF 10900 R

Persa i perket mekanikes bujqesore te nevojshme per kryerjen e aktivitetit te shoqerise, mund te themi qe eshte e kompletuar mjaftueshem. Pervec mjeteve te mbartura nga viti 2015, gjate vitit 2016 jane shtuar edhe mjetet e mekanikes bujqesore te meposhtme:

- Freze me aksesoret e nevojshem.
- Makine per lidhjen e barit.

Gjate vitit 2018 jane shtuar keto mjete bujqesore dhe agregate bujqesore:

Mekanizimi bujqesor luan nje rol gjithnje e me te rendesishem ne prodhimin bujqesor; ai zvogelon angarite, rrit sigurine dhe komoditetin e mjedisit te punes; rrit produktivitetin, intensitetin e mbjelljes se bimeve dhe te prodhimit. Blerja e ketyre makinerive te reja ka shkurtuar kohen, rritjen e prodhimtarise, si dhe sigurojne me shume te ardhura.

**a. Traktor Antonio TGF 10900 R**

*Karakteristikat*

1. Pajisja eshte ne perputhje me standardet e CE dhe me origjine italiane.
2. Ky traktor sherben per punimin, plugimin dhe frezimin e tokes.

**b. Trince e re Rinieri mod. TRV 200**

*Karakteristikat*

1. Pajisja eshte ne perputhje me standardet e CE dhe me origjine italiane.
2. Sherben per heqjen e barerave dhe degeve, permes spostimit anesor hidraulik.
3. Disku vendoset ne anesore te Trinces dhe krijon mundesine e futjes se saj midis pemeve.
4. Spostohet automatikisht kur has ne peme, duke ruajtur te gjitha druret frutoret nga demtimi.

**c. Freze Breviglieri mod. B83/180**

*Karakteristikat*

1. Pajisja eshte ne perputhje me standardet e CE dhe me origjine italiane.
2. Sherben per frezimin e tokes me gjeresi punuese 189 cm dhe thellesi punuese 10-20 cm.





3. Perbehet nga 48 thika ne total, pajisur me trasmesion kardanik me nje peshe totale 520 kg.

#### **d. Freze me spostim Rinieri mod. FS220/85**

##### ***Karakteristikat***

1. Pajisja eshte ne perputhje me standardet e CE dhe me origjine italiane.
2. Gjeresia punuese eshte 85 cm, dhe punon me nje distance minimale midis rreshtave 350cm dhe maksimale 600 cm.
3. Peshat: 390kg, eshte e pajisur me nje trasmesion kardanik dhe fuqi motorike 40hp.

#### **2. Makineri automatike per pergatitjen e vllajeve – Ofertues “Cosmeco S.R.L” - Itali**

##### ***Karakteristikat***

1. Kostoja e kesaj makinerie bujqesore eshte 6,699 Euro.
2. Pajisja eshte ne perputhje me standardet e CE dhe me origjine italiane.
3. Ofron nje punim te tokes se sheshte permes shtrimit te plastmasit per mbjellje ose te materialeve te tjera agro-tekstile.

Plastmasi gradualisht zbrazet poshte permes rrotulluesve te tij dhe fiksohet me saktesi ne toke, permes mekanizmave anesore te cilat mundesojne dhenien forme te tokes, ne pershtatje me plastmasin.

4. Realizon shtrimin e tubave te vaditjes pergjate gjithe vllajeve dhe njekohesisht edhe vendosjen e fidaneve.

#### **3. Plug Bujqesor dhe pompe sperkatese – Ofertues “Izet Leshi P.F”**

##### **1. Plug Bujqesor me 4 veshe**

##### ***Karakteristikat***

1. Kostoja e kesaj pajisjeje bujqesore eshte 3,360 Euro.
2. Kjo pajisje origjinon nga Italia.
3. Eshte e perbere nga 4 veshe ose thika per punimin e tokes.

##### **2. Pompe sperkatese**

##### ***Karakteristikat***



1. Kostoja e kesaj pajisjeje bujqesore eshte 2,070 Euro.
2. Kjo pajisje origjinon nga Turqia.
3. Sherben per spekatjen me gurkali (ose helme te tjera) te pemeve.

Mjetet e transportit te administrates;

- 1 veture 4x4 per nevojat e administratorit;
- 1 veture e vogel per nevojat e administrates;
- 1 furgon per transport te stafit dhe nevojave te ndryshme;
- 1 motor papaq per levizjet e specialisteve te bujqesise neper parcela.

Mjetet e transportit te prodhimit;

- 1 furgon 1,5 ton, per transport te prodhimit nga magazina ne tregun e shumices Kashar apo ne destinacione te tjera te tregut;
- 1 (te konsideruar) "dum-dum-kama", per transport te prodhimeve nga parcelat ne magazine;
- 1 (mjet tip Fiat Doblo per transportin e prodhimit nga sera ne magazine dhe nga magazine ne kliente.



## 5. Sistemi elektrik

Sistemi elektrik ne varesi te bllokut te parcelave; per kete sistem deri me tani eshte investuar rreth 2,5 milion leke. Ky sistem perbehet nga 3 lidhje (kabina/transformator/ shtylla, etj) tashme te kryera ne mbeshtetje te nevojave te 2 grupimeve te puseve per pemet frutore dhe perimet e fushes, si dhe nga lidhja e trete prane dhe ne funksion te funksionimit te serrave. Tashme eshte e njohur situata problematike, kontaktet dhe negociatat midis BAI dhe OSHEE per te qartesuar dhe zgjidhur mosmarreshjet teknike dhe institucionale, te konsideruara tani te kaluara. Si pasoje, pergjate muajit Tetor 2015, u realizua edhe lidhja e trete, pikerisht ne kohën kur energjia ishte domosdoshmeri prane bllokut te serave ne ndertim asokohe.

Sistemi elektrik perbehet nga 3 kabina elektrike, ne varesi te sistemit te pompave dhe te sistemit te serave. Disa elemente te mbajtura parasysh persa i perket furnizimit me energji nga pika e lidhjes dhe deri tek konsumatorët perfundimtare jane:

Studimi dhe perpunimi i te dhenave per piken e lidhjes me energji nga rrjeti kryesor.

- Studimi per pozicionimin e kabines ne tension te mesem (T.M) dhe tension te ulet (T.U), duke marre parasysh vendodhjen sa me afer me konsumatorët potencialisht me te fuqishem te kompleksit per minimizimin e humbjeve dhe optimizimin e furnizimit me energji me shpenzime sa me te uleta.
- Studimi dhe paraqitja opsionale e shfrytezimit te burimeve alternative te energjise me kosto me te ulet shfrytezimi (p.sh. panelet diellore) ne funksion te minimizimit te kostove te mirembajtjes.
- Studimi per zhvillimin e rrjetit te brendshem shperndares te energjise dhe pozicionimi sa me i sakte i paneleve sekondare per cdo element perberes te kompleksit te agrobiznesit, ne varesi te planvendosjes se te gjithe konsumatoreve .

Aktualisht, ka perfunduar investimi i tre kabinave elektrike, te cilat jane funksionale dhe jane marre ne dorezim nga OSHEE.

Nje prej kabinave elektrike

## 6. Ruajtja e territorit



Eshte realizuar rrethimi i godines qendrore, jane vendosur kamerat e sigurise dhe aktualisht ruhet me punonjesit e kompanise ne cilesine e rojeve. .

Gjithashtu, eshte rrethuar e gjithe siperfaqja e pemeve frutore, ne menyre qe brigadat te kujdesen sa me mire per mbarevajtjen e ketij investimi mjaft te rendesishem per fermen tone. Ka perfunduar rrethimi i te gjithe siperfaqes se tokes se administruar nga BAI.

Siperfaqja totale e rethimit te kryer eshte 11530 ml.

## **7. Mbjellja e drureve frutore**

Per mbjelljen e drureve frutore si nje nder aktivitetet kryesore te kompanise, por edhe per serat, u realizua nje vizite ne Izrael. Gjate vizites se kryer ne Israel, pervec diskutimit te serave tip tunel, nje nga kompanite qe takuam per furnizimin me fidane ishte Kompania "Ben Dor", e cila pervec prodhimit dhe furnizimit te fidaneve, shprehu edhe deshiren per nje biznes te perbashket, duke marre persiper shitjen e prodhimeve tona ne tregun e Europes Perendimore dhe ne Rusi. Ofertat e marra nga ana e tyre per fidanet e kerkuar prej nesh, ishin mesatarisht 7 Euro per fidane te prodhuar ne Israel, dhe 5 Euro per fidane te prodhuar ne Turqi. Duke ju shtuar ketyre cmimeve transportin dhe detyrimet doganore, kostoja u vleresua shume e larte.

Struktura e pemeve frutore te mbjella eshte si vijon:

- Kajsi – 4.000 fidane
- Nektarine – 5.000 fidane
- Pjeshke – 1.000 fidane
- Dardhe - 3.200 fidane
- Kumbull – 2.800 fidane
- Shege – 650 fidane
- Mandarine – 450 fidane

Gjithashtu, gjate vitit 2015, jane kryer te gjitha sherbimet e nevojshme per keto kultura frutore, dhe gjate periudhes Tetor 2015 - Janar 2016, eshte investuar per ndertimin e struktures mbeshtetese (960 bandiera), me dy rreshat tel per lidhjen e gjithe kultures "Dardhe".



## Struktura mbeshtetese e Dardhes

*Plantacioni Pemeve Frutore* Drejtimi i dyte i rendesishem ne aktivitetin e kompanise, pemet frutore, ne nje siperfaqe prej rreth 28 ha, dhe me rreth 16.000 fidane te llojeve nektarine, pjeshke, kajsi, kumbull dhe dardhe, vleresohen sot ne gjendje te mire. Sipas inventarit te kryer ne muajin qershor 2015, perqindja e zenieve eshte ne nivelin e rreth 99%. Sherbimet me te rendesishme te kryera ne pemet frutore pergjate 2015; 2016 dhe 2017 kane qene: punimi i tokes; vadijtja fillestare ne rrenje per te gjitha frutoret, ne nje sasi prej 12-15 lit/rrenje per sigurimin e zenies se tyre pas mbjelljes; 4 sperkatje ndaj semundjeve dhe demtuesve (flutura amerikane, merimanges, shushunjës së dardhes, etj) ne te gjitha siperfaqen (perjashtuar dardhen); harrjet pas mbjelljes, jane kryer 3 harrje te thithakeve ne trupin e bimes, si dhe pastrimi i nenshartesave.

Ne kushtet e thatesires se tejzgjatur, nga muaji Qershor e deri ne fund te Gushtit, domosdoshmeri dhe rendesi te vecante mori vadijtja me zorre ne cdo rrenje te pemeve frutore me

10-12

lit/rrenje.

Duke shfrytezuar 2 puset/pompat prane pemeve, u arrit qe vadijtja te kryhej deri ne 3 here per cdo fidane te frutoreve, e organizuar me dy turne punetoresh. Ne te gjitha siperfaqen e pemeve, jane kryer 2 prashitje (punime rreth fidanit) dhe nje prerje bari ne siperfaqen masive te parcelave. Prashitja e fundit (fillim Shtatori) u shoqerua edhe me plehera azotike. Nderkohe, te rendesishme shfaqen sherbimet ne periudhen e dimrit 2015-2016.

Gjate Nentor-Dhjetorit eshte bere pleherimi i plote ne cdo rrenje me pleh organik (10-12 kg/rrenje), punimi i tyre, si dhe eshte realizuar krasitja e pemeve (perjashtuar dardhen ne proces) dhe sperkatja me leng bordolez.

Proces i rendesishem si nje investim afatgjate tek dardha, eshte edhe vendosja e bandierave te betonit ne sherbim te lidhjes se degeve te saj, per formen qe mori ajo lloj dardhe (palmet). U vendosen rreth 950 bandiera per nje siperfaqe rreth 4 ha dardhe. Shqetesim i shfaqur tek dardha asokohe, ishte prezenca e nje paraziti-krimb ne nje numer te kufizuar te fidaneve, i cili demton trungun dhe kercellin. Luftimi i ketij paraziti, eshte kryer me mjete mekanike (me tel), duke depertuar ne trung dhe duke shkaterruar vegjetimin e tij.

Ky infektim, ka ardhur nga infektimi i zones ne te cilen gjenden pemet e fshatareve te patrajuara kunder demtuesve.



Gjate vitit 2018 u ndertua edhe sistemi i vaditjes per pemtoren si me poshte vijon:

Sistemi i vaditjes me pika, si forma me e persosur e cila aplikohet ne te gjithe kulturat bujqesore, si: Ne perimore (kushtet e fushes dhe te mjediseve te mbrojtura), ne frutikulture, ne kulturat e drithrave. Ofertues ishte shoqeria NaanDanJain.

**Avantazhet qe sjell ky investim:**

- Ujitet ne cdo ore te dites, pa krijuar asnje shqetesim fiziologjik tek bimet; Mundesohet nje shperndarje uniforme uji ne te gjithe siperfaqen, madje ne menyre te kontrollueshme deri ne ate thellesi toke, saeshte i shtrire sistemi rrenjor i bimeve;
- Menjanohet lagja e siperfaqes se tokes, siç ndodh ne rastet e ujitjeve me permbytje apo brazda, duke eleminuar plotesisht mundesine e infektimit nga semundjetqe vijne nga siperfaqja e tokes;
- Eleminohet kontakti direkt i ujit me gjethet dhe bimen ne pergjithesi, duke evituar jo vetem rritjen e lageshtires se panevojshme te ajrit, por edhe mundesine e prekjes nga semundjet kerpuadhore;
- Cilesia e ujitjes me pika realizohet shume mire, pavaresisht se kushtet e motit jane te papershtateshme;
- Lejon mundesine e menaxhimit te sasise se ujit ne varesi te kerkesave te bimeve, sipas fazave te rritjes dhe te zhvillimit te tyre

**Serat**

Nje nga detyrat kryesore te kompanise BAI per vitin 2016, ishte hartimi dhe zbatimi i nje plani sa me te detajuar per ndertimin e serave me qellim prodhimin e perimeve ne sera, nga ato te thjeshtat deri tek ato high-tech. Ndertimi dhe venia ne funksionim e serave periodikisht vit pas viti eshte nje nder objektivat kryesore te sipermarrjes "Besa Agro Invest shpk", bazuar dhe ne detyrimet kontraktuale me Ministrine e Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave.



Per keto sera, u kontaktuan disa kompani te huaja dhe vendase, midis te cilave rendisim: Top Greenhouse Israel, Mediane Spanje, Azrom Israel, Piraci Shqiperi dhe Sera Lushnja. Per te rritur ne maksimum te ardhurat per vitin 2015, u planifikua investimi ne 2,5 ha sera te thjeshta tip tunel (dy tipe tunelesh; te thjeshta dhe tunele ne bateri) pa ngrohje qendrore per prodhimin e kulturave te ndryshme.

Ne perfundim te shqyrtimit te ofertave te ardhura, Komisioni i Shqyrtimit vendosi qe te procedohet me kompanine AZROM nga Izraeli, si kompania qe paraqiti oferten me te mire dhe me te lire. Gjithashtu, po me kompanine AZROM, lidhem marredhenie kontraktuale per te hartuar Biznes Planin per prodhimin e perimeve ne serat high tech me plasmas.

Per kete qellim, ne kete periudhe te pare u projektua, financua dhe perfundoi ndertimi i nje siperfaqeje prej rreth 2.5 Ha sera tunel, te shtrira ne 39 tunele te vecanta ku cdo tunel eshte ne permasat (64m X 9,6m apo 615 m<sup>2</sup>). Risjellim ne vemendje se struktura e serrave (apo e tuneleve) eshte blere prane firmes izraelite AZROM.

Nepermjet ketyre serave diellore me plasmas, u arrit prodhimi pergjate diteve te fundit te muajit Prill dhe muajit Maj e ne vazhdim, ku avantazh perben fakti qe tregtuam prodhime te fresketa 1 deri 2 muaj para se sa te fillonte furnizimi ne treg nga fermeret e perimeve te fushes, duke arritur fitime kryesisht per pasoje te cmimit te mire te shitjes dhe kostos se prodhimit.

U be dhe u implementua planifikimi per mbjelljen e kesaj siperfaqeje me perime te ndryshme gjate fundit te Shkurtit 2016 e ne vazhdim.

### **Projekti Sera**

Ndertimi dhe venia ne funksionim e serave periodikisht, ka qene nder objektivat kryesore te "Besa Agro Invest shpk" pergjate vitit 2015, bazuar dhe ne detyrimet kontraktuale me Ministrine e Bujqesise Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujerave.

Per kete qellim, gjate vitit 2015, si vit i pare i nje aktiviteti te plote u projektuan, financuan dhe u vune ne funksionim, serat e para tunel ne nje siperfaqe prej rreth 2,4 ha, te shtrira ne 39 tunele te vecanta, ku cdo tunel eshte ne permasat (64m x 9,6m apo 614 m<sup>2</sup>).

Risjellim ne vemendje se struktura e serave (apo tuneleve) eshte porositur dhe blere prane



firmes izraelite AZROM, ne nje vlere kontrate prej 357,540 US\$. Ne kete vlere eshte perfshire edhe sistemi i komandimit te sistemit te vaditjes prane cdo tuneli.

Procesi i ngritjes se serave kaloi neper disa faza:

Pergatitja e siperfaqes se serave dhe realizimi i procesit te tenderimit gjate periudhes Qershor-Korrik 2015 per 3 procese baze : pergatitja e siperfaqes, ngritja e bazamenteve te betonit dhe montimi i struktures se tuneleve. E drejta per sistemimin r siperfaqes, ju dha firmes BAMI shpk, ne nje vlere rreth 2,3 milion leke, ndersa e drejta per ndertim/montimin e serave, ju dha firmes AMU shpk, per nje vlere totale prej 10,000,000 lekesh, dhe per nje kohezgjatje 3 mujore (Gusht-Tetor 2015). Firma fituese realizoi punimet ne konformitet me kushtet e kontrates dhe projektit, duke punesuar mesatarisht 25-30 punetor ne dite, nje pjese prej te cileve ishin punetore te brigadave te BAI.

#### **Gjendja dhe funksionimi i serave;**

Pasi perfundimit dhe montimit te plote te serave ne 39 tunele ne totalin e tyre, pergjate muajit Nentor 2015 u vune ne shfrytezim 7 tunelet e pare ne rreth 4 dy, per tu mbjelle me sallate dhe spinaq (6 sallate dhe 1 spinaq). Vjelja e prodhimit prej tyre filloi ne fund te Dhjetorit te 2014, prodhimi i sallate rezultoi i mire dhe arriti ne rreth 150 kv/ha.

Infrastruktura ne brendesi te serrave; pavaresisht trajtimit edhe teresise se investimeve te kryera ne kompani, rruget brenda serave, rruga qe lidh serat me zyrrat, si dhe kolektori i shkarkimit te ujerave te teperta, mbeten nder investimet me te rendesishme dhe te kryera me shpejt, pasi kane perfunduar brenda nje periudhe pune 1-2 mujore. Ky investim ne infrastrukture ka bere funksionale rreth 1 km rruge te brendshme rurale me cakull, per nje vlere rreth 8 milion leke.

Per shfrytezimin e menjehershem dhe intensiv te siperfaqes se serave, u planifikua dhe implementua mbjellja e tyre me perimet e pranveres, ne te gjithe siperfaqen prej 2,4 ha;

Per kete prodhim te planifikuar u blene farat dhe u porositen fidanet e duhur prane kompanive te specializuara per rritje fidani, te cilat u mbollen ne sera pergjate diteve te para te Marsit te 2016 dhe ne vazhdim , pergjate periudhes se pranveres. Ne mbeshtetje te nevojave agroteknike te perimeve, cdo tunel u pleherua paraprakisht me rreth 80 kv/dy pleh organik, si dhe u trajtua me pesticidet e nevojshme ndaj demtuesve te ndryshem. Sipas planin teknologjik, perimet ne sera u vaditen me sistemin vadites me pika, pjese e projektit te realizimit te serave, si dhe u ushqyen me pleherime te treteshme NPK.





Ne sera, u be mbjellja e disa perimeve te ndermjetme si sallate, selino, rukola, etj ; me synim shfrytezimin maksimal te siperfaqes se serave, si nje siperfaqe me kushte optimale per perimet, duke kultivuar njekohesisht perimet baze domate, spec, etj, te shoqeruara dhe nga ato te ndermjetmet.

Gjithashtu, gjate vitit 2016 filloi puna per ndertimin e 2.5 ha sera te reja. Me perfundimin e tyre siperfaqja e serave ne shfrytezim shkoi ne 5 Ha.

Me marrjen e lejes se ndertimit nga Bashkia Kruje, me date 1.09.2016 , filloi puna per ndertimin e tyre. Punimet u kryen nga shoqeria “AMU”SHPK.

### **Ne vitin 2018 u realizuar investimi per ndertimin e 1 Ha Serre Diellore:**

Kulturat e mbjella ne kete siperfaqje jane kryesisht domate, spec, dhe trangull, si produkte shume te kerkuara nga tregu vendas, por gjithashtu edhe per eksport.

Ky investim beri te mundur:

1. Mundesimi i realizimit te objektivave te shoqerise, per rritjen e sasise se prodhimit per eksport.
2. Investimi ne 1 Ha sere, si pjese e planit afatgjate te biznesit te shoqerise Besa Agro Invest Sh.p.k, per ndertimin total te nje siperfaqje prej 20 Ha sera.
3. Perfitimi nga fondi i Qeverise Shqiptare per zhvillimin bujqesor dhe rural 2018, ne vazhdim te eksperiences ne ndertimin e 2.4 Ha sera te ndertuara pergjate vitit 2015 dhe vitit 2016-2017, te cilat kane qene pjese e skemes se fondit per zhvillim bujqesor dhe rural 2015-2016.

Fokusi i prodhimeve tona eshte tregu i brendshem dhe eksporti.

Per 2017, i gjithe prodhimi u destinua per tregun e brendshem. Gjithashtu, permes dy prej klienteve tane qe merren me veprimtarine e eskportit, u be e mundur te eksportohej nje sasi e madhe e produkteve “sallate daneze” dhe “domate e kastravec”.

Konsumatoret kryesore te produkteve tona jane tregjet vendase, dhe synohet per rritjen e kapaciteteve per bashkepunim me tregun e huaj. Ne tregun vendas, duke qene se kompania jone ndodhet ne nje pozicion gjeografik te favorshem prej aksesit ne rrugen nacionale, avantazhohet aksesimi ne tregjet me te medha urbane si ai i Tiranes, Durresit, tregjet e zones



se Veriut, si dhe bashkepunimi me Kosoven. Shitja e produkteve tona eshte realizuar edhe me industrine perpunuese ne Tirane.

Si rezultat i implementimit te investimit te ri, u realizua nga ana jone jo vetem rritja e sasise se disponueshme per treg, por njekohesisht edhe nje rritje dhe diversifikim i klienteles.

Ne lidhje me tregun e synuar, fokusi yne kryesor eshte tregu vendas, i cili krijon kerkese per ruajtjen e produkteve bujqesore. Ne kete treg, konsiderojme tregtaret e shumices dhe tregun e pakices.

Qe nga fillimi i aktivitetit, kemi bere perpjekje per njohjen e tregut ne teresi, llojet e produkteve qe kerkon ky treg, çmimet e tyre dhe konkurrentet me kryesore.

### **Teknologjia dhe procesi i prodhimit:**

Modeli i seres eshte i tipit shumeharkesh. Ne nje siperfaqje prej 1 Ha me dimensione 110m x 90.8m, konstruksioni metalik eshte nje material i galvanizuar ne te nxehte dhe jetegjatesia e seres paraqitet me teper se 15 vjet. Lartesia e kraheve eshte 4 m, ndersa lartesia ne kulm e harkut eshte 6.6 m. Sistemi i ajrosjes eshte anesor dhe elektrik. Gjithashtu, pjesa e ajrosjes ne anesore, eshte e pajisur me rrjete per ndalimin e insekteve ne sera. Trashesia e plastmasit eshte 200 mikron dhe cilesia eshte shume e larte.

Sistemi i vaditjes do te jete i automatizuar nga nje dhome qendrore, e cila ka pajisjet e nevojshme per automatizimin e perzierjeve te plehrave dhe vaditjen e gjithe siperfaqes. Vaditja eshte e planifikuar me pika ne cdo rrenje bime.

### ***Pajisjet e nevojshme***

Pajisjet e nevojshme permes se ciles u realizua investimi jane materialet e seres (te cilat jane mall importi), dhe gjithashtu, mjetet e nevojshme per ndertimin e seres. Materialet dhe montimi, jane realizuar nga shoqeria "REAL A&B" Shpk.

Pajisjet e nevojshme per ndertimin e serave, jane obligim i firmes qe do te beje ndertimin e seres ne terren, "REAL A&B" Shpk, per tecilen do te hartohet kontrata me detyrimet respektive per implementimin e ketij investim.

### **Investime te tjera te kryera gjate periudhes Qershor 2018 – Qershor 2019 jane**



1. Dhoma Frigoriferike per ruajtjen e produkteve te gatshme.
2. Blerja e nje Peshoreje Elektronike.

Me poshte, paraqiten te detajuara secila nga investimet lartepemendur

### **2.1-Dhoma Frigoriferike**

BAI-shpk gjate 2018, nisi implementimin ne ambientet e saj te struktures se dhomes frigoriferike.

#### **Avantazhet e sjella nga ky investim:**

- Ruajtja e te gjithavlerav eushqyese te perimeve.
- Mbajtja e produkteve te fresketa per nje periudhe afatgjate.
- Mundesia e krijimit te nje pike grumbullimi per produktet efermereve te zones, ne perputhje me objektivat e aktivitetit te shoqerise.

### **2.2-Peshore elektronike**

#### **Platforme Peshimi me 4 sensore**

Te pershtatshme per aplikimin e peshimit te cdo lloj materiali dhe ne cdo fushe te industrise dhe te tregtise.

E pozicionuar ne nje nivel me siperfaqen e dyshemese ose mbi dysheme, lehtesisht e manovrueshme.

Mundesi lidhjeje me treguespeshe per sensoret e ngarkeses. Me sensore konform standardeve te miratuara ngaKomiteti European(KE).

Investimet e mesiperme kane ndihmuar ne permiresimin e veprimtarise ekonomike te shoqerise. Mirepo me date 26 Nentor 2019 shoqeria mori nje goditje nga termeti I dates 26.11.2019 iu magnitudes 6.4 per te cilen u demtua godina e marre me qera per ambientet e administrates dhe magazines. Kjo goditje solli jo pak shpenzime per shoqerine per te cilen iu desh qe te transferonte zyrat perkohesisht ne ambiente te pershtatura per vazhdimesine e punes se administrates, e tille si blerje e nje zyre te gatshme me permasa 4 m \* 2.5m \* 2.4m.

#### **Mbi demet nga permybtja e dates 22 Shtator 2019**



Ne daten 24 Shtator 2019 u mbajt komisioni per verifikimin e demeve nga permytja e dates 22 Shtator 2019 per te cilen u perllogarit qe demi fiannciar I kryer nga shoqerise Besa Agro Invest Sh.p.k ishte ne masen 7,954,941.79 LEKE. Per keto deme jane derguar shkresa ndaj institucioneve te tilla si Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, Drejtorise Rajonale Bujqesore per verifikimin ne terren te demeve te shkaktuara.

Aktualisht shoqeria Besa Agro Invest eshte duke u perpjekur per te rikuperuar demet e ndodhura gjate vitit te kaluar dhe per kete jane hartuar strategji te reja te prodhimit dhe shitjes se produktit te gatshem dhe njekohesisht jane marre masat per evitimin e permytjeve te tilla si kullimi I parcelave, hapjen e kanaleve te reja kulluese e etj.

**ADMINISTRATOR**

**Etmond SHkemi**

